

Z. Paolo Xhezo ka mbaruar studimet e larta të nivelit “Master Shkencor” në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në degën “Arkitekturë”, prej vitit 2010 deri në vitin 2015.

Z. Xhezo ka qenë pjesë e sektorit privat për një periudhë më shumë se shtatë vjeçare, në të cilën është angazhuar në fushën e arkitekturës dhe ndërtimitarisë brenda dhe jashtë vendit.

Z. Xhezo prej vitit 2022 është pjesë e stafit të KLSH-së dhe ka mbajtur pozicionin e “Audituesit të Parë”, pranë Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Aktualisht është i emëruar në pozicionin e “Kryeaudituesit” pranë Departamentit të Auditimit të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Pronës Publike, Sektori i Auditimit të Pronës Publike.

Përgjatë karrierës së tij si Auditues i Parë dhe Kryeauditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Z. Xhezo ka ndjekur një sërë kualifikimesh dhe trajnimesh nga institucione dhe organizata prestigjioze ndërkombëtare, përfshirë këtu EUROSAT WGEA, Zyra Supreme e Auditimit, Poloni, Zyra Supreme e Auditimit, Republika Çeke, Gjykata e Auditimit në Hollandë (NCA), Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar (UK NAO), EUROSAT, etj. Gjatë këtyre trajnimeve z. Xhezo është trajnuar mbi tema të ndryshme, si: *Energjia e qëndrueshme – Sustainable energy; Siguria e Energjisë; Ndryshimet Klimatike; etj.*